

# MULTI KULTU RALI ZMI

dhe komunitetet kombëtare më  
pak të përfaqësuar në sistemin  
arsimor malazez



Centar za  
građansko  
obrazovanje | Centre  
for Civic  
Education



Fond za kulturu  
i obrazovanje  
Ministritë e arsimit

# Multikulturalizmi dhe komunitetet kombëtare më pak të përfaqësuara në sistemin arsimor malazez

## **Botuesi:**

Qendra për Arsimitim Qytetar (QAQ)

## **Redaktore:**

Daliborka Ulareviq

## **Autori:**

Vasilije Raduloviq

## **Bashkëpunëtoresh:**

Tamara Milash

Monika Mrnjaçeviç

## **Përkthimi në gjuhën shqipe:**

Monika Mrnjaçeviç

## **Dizajni dhe produksioni:**

Qendra për Arsimitim Qytetar (QAQ)



Publikimi "Multikulturalizmi dhe komunitetet kombëtare më pak të përfaqësuara në sistemin arsimor malazez" u krijua si pjesë e projektit "Multikulturalizmi, popujt pakicë dhe komunitetet e tjera kombëtare pakicë në sistemin arsimor malazez", i cili zbatohet nga Qendra për Arsimitim Qytetar me mbështetjen financiare e Fondit për Mbrojtjen dhe Realizimin e të Drejtave të Pakicave.

Përmbajtja e publikimit është përgjegjësi e vetme e Qendrës për Arsimitim Qytetar (QAQ) dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e Fondit për Mbrojtjen dhe Realizimin e të Drejtave të Pakicave.

# MULTI KULTU RALI ZMI

dhe komunitetet kombëtare më  
pak të përfaqësuara në sistemin  
arsimor malazez

Podgoricë, 2023.

# Përmbajtja

01	Korniza normative	5
02	Dokumentet ndërkombëtare	7
03	Këndi statistikor	11
04	Multikulturalizmi dhe ndërkulturaliteti - parakushtet për bashkëjetesë të qëndrueshme në mes kulturave të ndryshme	14
05	Ndërkultura në procesin arsimor	15
06	Përfundime dhe rekomandime	22

# Korniza normative

Të drejtat e anëtarëve/eve të komuniteteve pakicë dhe komuniteteve të tjera kombëtare pakicë në fushën e arsimit janë rregulluar me Kushtetutën e Malit të Zi<sup>1</sup>, Ligjin mbi të Drejtat dhe Liritë e Pakicave<sup>2</sup>, Ligjin e Përgjithshëm të Arsimit dhe Edukimit<sup>3</sup>, si dhe me ligje të tjera dhe akte nënligjore që rregullojnë fushën e arsimit.

Kushtetuta parashikon se anëtarët/et e komuniteteve pakicë dhe komuniteteve të tjera kombëtare pakicë kanë të drejtën të shkollohen në gjuhën dhe shkrimin e tyre në institucionet shtetërore, si dhe që programet mësimore të përfshijnë historinë dhe kulturën e tyre.

Kjo normë kushtetuese zhvillohet më tej në Ligjin mbi të drejtat dhe liritë e pakicave, duke përcaktuar se lloji i këtij mësimi realizohet në të gjitha nivelet e arsimit dhe edukimit dhe nëpërmjet shkollave të veçanta ose klasave të veçanta në shkollat e rregullta. Gjithashtu, Ligji përcakton se mësimi duhet të zhvillohet sipas një programi që përmbanë tema të historisë, artit, letërsisë, traditës dhe kulturës së komuniteteve pakicë dhe komuniteteve të tjera kombëtare pakicë.

Ligji i Përgjithshëm i Arsimit dhe Edukimit veçon të drejtat e pakicave. Saktësisht, neni 11 parashikon se mësimi zhvillohet edhe në gjuhët në përdorimin zyrtar, duke respektuar të drejtat e pakicave kombëtare, duke përfshirë gjuhët e tyre në të cilat zhvillohet mësimi (bosnjakisht, shqip dhe

---

**1** Kushtetuta e Malit të Zi, "Gazeta zyrtare e Mali të Zi", nr. 001/07, 038/13

**2** Ligji për të Drejtat dhe Liritë e Pakicave, "Gazeta zyrtare e Republikës së Malit të Zi", nr. 031/06, 051/06, 038/07, "Gazeta zyrtare e Malit të Zi", nr. 002/11, 008/11, 031/17

**3** Ligji I Përgjithshëm për Arsimin dhe Edukimin, "Gazeta zyrtare e Republikës së Malit të Zi", nr. 064/02, 031/05, 049/07, "Gazeta zyrtare e Mali të Zi", nr. 004/08, 021/09, 045/10, 073/10, 040/11, 045/11, 036/13, 039/13, 044/13, 047/17, 059/21, 076/21, 146/21, 003/23

kroatisht). Më tej, neni 13 parashikon se *“kur mësimi zhvillohet në gjuhën e pakicave kombëtare dhe komuniteteve të tjera pakicë, është e obligueshme të mësohet gjuha dhe shkrimi zyrtar.”*

Ky ligj parashikon që për vendosjen e çështjeve profesionale dhe për ndihmën profesionale në vendimmarrje dhe përgatitjen e rregulloreve në fushën e arsimit, krijohet Këshilli Kombëtar, si edhe që një e treta e anëtarëve/eve të Këshilli Kombëtar zgjidhet nga radhët e përfaqësuesve/eve të popujve pakicë dhe të bashkësive të tjera kombëtare pakicë.

Kur bëhet fjalë për punësimin e personelit mësimdhënës, ligji parashikon që mësuesit/et, në institucione ose në departament të veçantë të institucioneve me mësimdhënie në gjuhën e anëtarëve të kombeve pakicë dhe të komuniteteve të tjera kombëtare pakicë, duhet të kenë, përveç kushteve të përcaktuara me ligj, njohjen aktive të gjuhës dhe shkrimit të asaj pakice dhe të gjuhës malazeze. Në shkollë ku mësimi zhvillohet në gjuhën e pjesëtarëve/eve të kombeve pakicë dhe të bashkësive të tjera kombëtare pakicë, procesverbalet pedagogjike shtypen dhe mbahen në gjuhën malazeze dhe në gjuhën e pjesëtarëve të kombeve pakicë dhe të bashkësive të tjera kombëtare pakicë, dhe e njëjta gjë vlen për lëshimin e dokumenteve publike.

Promovimi i mirëkuptimit dhe tolerancës reciproke reflektohet në konceptimin e lëndëve të detyrueshme dhe zgjedhore. Përkatësisht, nxënësit/et fitojnë njohuri dhe aftësi në fushën e të drejtave të njeriut dhe vlerave të ndërkulturalizmit në kuadër të lëndëve të detyrueshme dhe zgjedhore. Gjithashtu, shkollat janë të detyruara të përfshijnë 20% të përbajtjes mësimore në kurrikulën e hapur, e krijuar nga mësuesit/et, prindërit dhe shkollat në bashkëpunim me komunitetin lokal. Kjo hap hapësirë për të kontribuar në realizimin e të drejtës për të studiuar specifikat e gjuhës, kulturës, historisë dhe veçorive të tjera të pakicave, veçanërisht ato që përbëjnë mjedisin në të cilin shkolla punon.

Së fundi, neni 9 i Ligjit të Përgjithshëm për Arsimin dhe Edukimin parasheh ndalimin e diskriminimit në fushën e arsimit.

Në përgjithësi, korniza normative orienton sistemin e arsimit dhe edukimit drejt zhvillimit të vlerave demokratike dhe krijimit të një mjedisi pa përjashtim social apo forma të tjera trajtimi diskriminues.

# Dokumentet ndërkombëtare

Dokumentet ndërkombëtare në këtë fushë synojnë të promovojnë barazinë, integrimin dhe ruajtjen e identitetit kulturor të pakicave kombëtare nëpërmjet edukimit. Qëllimi i tyre është të sigurojnë që pakicat kombëtare të kenë akses në arsim cilësor dhe që nevojat dhe identitetet e tyre specifike të respektohen në sistemin arsimor.

Dokumentet ndërkombëtare të rëndësishme në fushën e arsimit të pakicave janë Rekomandimet e Hagës për të Drejtën e Pakicave Kombëtare për Arsim<sup>4</sup> dhe Udhëzimet e UNESCO-s për Arsimin Ndërkulturor<sup>5</sup>.

Rekomandimet e Hagës janë miratuar në vitin 1996 nga OSBE, me qëllim të afirmimit dhe mbrojtjes së të drejtave të pakicave kombëtare në fushën e arsimit.

Ato përfshijnë parimet në vazhdim:

1. barazinë - pakicat kombëtare duhet të kenë qasje të barabartë në arsim pa diskriminim në bazë të përkatësisë së tyre kombëtare ose etnike;
2. arsimimin në gjuhën amtare - pakicat kombëtare duhet të kenë të drejtën e arsimimit në gjuhën e tyre, përkatësisht

---

<sup>4</sup> Rekomandimet e Hagës për të drejtën e pakicave kombëtare për arsim, OSBE, 1996, <https://www.osce.org/files/f/documents/1/a/32191.pdf>

<sup>5</sup> UNESCO guidelines on intercultural education, 2006, <https://unesdoc.unesco.org/ark:/48223/pf0000147878>

shteti t'u ofrojë mundësi për arsimim në gjuhën amtare, me mësimin e gjuhës zyrtare të shtetit;

3. kulturën dhe historinë - pakicat kombëtare duhet të kenë të drejtën e arsimimit që promovon kulturën, historinë dhe traditat e tyre, që do të thotë se sistemi arsimor duhet të jetë i krijuar në atë mënyrë që të mbështesë ruajtjen dhe zhvillimin e identitetit kulturor të pakicave kombëtare;
4. pjesëmarrjen në krijimin e sistemit arsimor - pakicat kombëtare duhet të përfshihen në vendimmarrje që kanë të bëjnë me arsimin, duke përfshirë zhvillimin e kurrikulave, materialeve mësimore dhe politikave që adresojnë arsimimin e pakicave kombëtare;
5. burimet arsimore - shtetet duhet të sigurojnë disponueshmërinë dhe aksesin në burimet adekuate arsimore për pakicat kombëtare, duke përfshirë shkollat, materialet mësimore, mësuesit e kualifikuar dhe financimin e duhur.

Udhëzimet e UNESCO-s për Arsimin Ndërkulturor jan grup parimesh dhe rekomandimesh të zhvilluara nga Organizata e Kombeve të Bashkuara për Edukim, Shkencë dhe Kulturë (UNESCO) për të promovuar mirëkuptimin, dialogun dhe respektin ndërkulturor në sistemet arsimore në mbarë botën. Këto udhëzime ofrojnë kornizë për edukatorët dhe vendimmarrësit që të inkurajojnë arsimin gjithëpërfshirës dhe të barabartë që njeh dhe vlerëson diversitetin kulturor.

Në atë drejtim u theksuan tre parime bazë:

1. edukimi ndërkulturor respekton identitetin kulturor të nxënësve/eve duke ofruar arsim cilësor kulturalisht të përshtatshëm dhe të përgjegjshëm për të gjithë;
2. edukimi ndërkulturor u siguron të gjithë nxënësve/eve njohuritë, aftësitë dhe qëndrimet kulturore që u nevojiten për të qenë qytetarë/e aktivë dhe të përgjegjshëm;



3. edukimi ndërkulturor u siguron të gjithë nxënësve/eve njohuri, aftësi dhe qëndrime kulturore që u mundësojnë atyre të kontribuojnë në respektin, mirëkuptimin dhe solidaritetin ndërmjet individëve/eve, grupeve etnike, sociale dhe kulturore dhe kombeve.

Parimi i parë mund të realizohet nëpërmjet përdorimit të kurrikulës dhe materialeve mësimore, zhvillimit dhe aplikimit të metodave të mësimdhënies përvojë dhe pjesëmarrëse të përshtatshme për kulturat e dhëna, më pas zhvillimin dhe aplikimin e metodave të vlerësimit në përputhje me specifikat e kulturave të ndryshme, zgjedhjen e gjuhës së mësimi (që nënkupton përdorimin e gjuhës amtare të nxënësve), duke inkurajuar atmosferë që respekton dallimet kulturore, arritjen e komunikimit mes shkollës dhe komunitetit, si dhe ndërvëprimin e prindërve dhe komuniteteve lokale në procesin arsimor. Ky parim përfshin trajnimin e mësuesve/eve me qëllim të rrisë nivelin e ndërgjegjësimit për rëndësinë e nevojave arsimore dhe kulturore të grupeve pakicë, por dhe forcimin e kapaciteteve të stafit mësimdhënës për të krijuar përmbajtjen edukative, metodat e punës dhe materialet që përdorin sipas nevojave të grupeve, kulturat e të cilave janë ndryshe nga shumica.

Parimi i dytë mund të realizohet duke garantuar kushte të barabarta në arsim për të gjithë pjesëtarët/et e kombeve pakicë, duke përdorur kurrikulën, librat dhe materialet e punës në mënyrë të tillë që t'i ofrojë njohuri kulturës/komunitetit shumicë për kulturat e pakicave, por edhe t'i mundësojë grupeve pakicë njohuri për shoqërinë në tërësi. Për më tepër, kjo përfshin mënyrë të përcaktuar qartë të vlerësimit të arritjeve të nxënësve, përmes vlerësimit të njohurive, aftësive, qëndrimeve dhe vlerave, duke përdorur gjuhë të përshtatshme mësimore që ofron mundësinë për secilin nxënës/e të shprehet në gjuhën amtare dhe në gjuhën zyrtare të shtetit.

Parimi i tretë realizohet nëpërmjet zhvillimit të kurrikules që kontribuon në vlerësimin dhe pranimin e diversitetit, aplikimin e metodave të përshtatshme të mësimdhënies, të cilat u përshtaten edhe pakicave

brenda grupit, edukimin e duhur të mësuesve/eve dhe zhvillimin e vazhdueshëm profesional, veçanërisht në drejtim të komunikimit në grupe heterogjene.

Instrumentet ndërkombëtare që kanë të bëjnë me arsimin në gjuhën e pakicave njohin të drejtën e minoriteteve për të ruajtur identitetin e tyre përmes gjuhës së tyre amtare, por gjithashtu theksojnë të drejtën për të marrë pjesë në komunitetin e gjerë kombëtar duke mësuar gjuhën zyrtare të shtetit. Prandaj, arritja e shumëgjuhësisë në mesin e pakicave kombëtare është një nga parakushtet për arritjen e qëllimeve që lidhen me mbrojtjen e pakicave kombëtare dhe integrimin e tyre. Rekomandimet e Hagës në lidhje me arsimin fillor dhe të mesëm ofrojnë udhëzime për zhvillimin e politikave arsimore në gjuhën e pakicave dhe zhvillimin e programeve të përshtatshme.

Kjo qasje tenton të krijojë hapësirë për ruajtjen e një gjuhe më pak të përfaqësuar. Është kundër qasjeve të tjera që fokusohen në mësimin e gjuhës të pakicës, apo edhe mësimdhëniet minimale në gjuhën e pakicës, vetëm për të lehtësuar kalimin të mëvonshëm në mësimdhënie ekskluzivisht në gjuhën zyrtare të shtetit. Gjithashtu, qasjet që mbrojnë asimilimin e plotë, ku kurrikula zhvillohet ekskluzivisht në gjuhën zyrtare të shtetit dhe ku fëmijët e pakicave integrohen plotësisht në klasa me fëmijë shumicë, nuk janë në përputhje me standardet ndërkombëtare. Duhet theksuar se kjo vlen edhe për shkolla të veçanta ku i gjithë programi mësimor mësohet ekskluzivisht në gjuhën amtare të pakicës gjatë gjithë procesit arsimor, ndërsa gjuha e shumicës nuk mësohet fare ose mësohet minimalisht.

# Këndi statistikor

Për të kuptuar më mirë pozicionin e anëtarëve/eve të kombeve pakicë dhe komuniteteve të tjera kombëtare pakicë në aspektin e arsimit në Mal të Zi, të dhënat statistikore nga dy vitet e fundit shkollore - 2021/2022 dhe 2020/2021 mund të jenë të dobishme.<sup>6</sup>

Në 2021/2022. ishin gjithsej 393 fëmijë (203 djem dhe 190 vajza) në institucionet parashkollore ku mësimi zhvillohet në gjuhën malazeze dhe shqipe. Bëhet fjalë për IPP "Kopshti" në Plavë, IPP "Gjina Vrbica" në Tuz, IPP "Vukosava Ivanoviq – Mashanoviq" në Tivar dhe IPP "Solidaritet" në Ulqin.

Në shkollat fillore ku mësimi organizohet në gjuhën malazeze dhe shqipe, numri i nxënësve/eve ishte 2612 (1338 djem dhe 1274 vajza). Këto shkolla janë: Shkolla Fillore "Marshall Tito", Shkolla Fillore "Marko Nucleoviq" dhe Shkolla Fillore "Boshko Strugar" në Ulqin; Shkolla Fillore "Mahmut Lekiq" në Tuz; Shkolla Fillore "Hajro Shahmanoviq" në Plavë dhe Shkolla Fillore "Xhafer Nikoçeviq" në Guci.

Shkollat e mesme dygjuhëshe kanë ndjekur gjithsej 810 nxënës/e, nga të cilët 420 djem dhe 390 vajza, në këto shkolla: Shkolla e Mesme e Përzier "25 Maj" në Tuz, Shkolla e Mesme e Përzier "Vëllazërim - Bashkim" në Ulqin dhe Shkolla e Mesme e Përzier "Beqo Bashi" në Plavë.

Shkollat e muzikës në gjuhën shqipe kanë ndjekur 183 nxënës/e

---

<sup>6</sup> Raport mbi zhvillimin dhe mbrojtjen e të drejtave të popujve pakicë dhe komuniteteve të tjera kombëtare pakicë, Ministria e Drejtësisë, të Drejtave të Njeriut dhe të Pakicave, <https://www.gov.me/dokumenta/31e98550-b9c2-4b8e-a8ca-d9f5a5344ba8>

(108 vajza dhe 75 djem), në: Shkolla Fillore e Muzikës në Ulqin dhe Institucioni Rajonal i Shkollës Fillore të Muzikës "Vasa Paviq" në Tuz.

Në gjuhën shqipe mësimi zhvillohej në gjashtë shkolla fillore: Shkolla Fillore "Gjergj Kastriot Skenderbeu" në Tivar; Shkolla Fillore "29. Nëntori", Shkolla Fillore "Bashkimi" dhe Shkolla Fillore "Gjergj Kastriot Skenderbeu" në Tuz; Shkolla fillore "Bedri Elezaga" në Ulqin dhe Shkolla Fillore "Dacaj" në Rozhajë. Arsimin fillor në gjuhën shqipe e kanë ndequr 2612 nxënës/e, nga të cilët 1338 djem dhe 1274 vajza. Mësimi në gjuhën shqipe u zhvillua edhe në Shkollën e Mesme Private "Drita" në Ulqin.

Në arsimin e lartë, në kuadër të programit të studimit për mësimdhënës në gjuhën shqipe në Podgoricë në vitin akademik 2021/2022 u regjistruan 62 studentë/e (37 djem dhe 25 vajza) dhe u ndanë katër bursa.

Në shtator të vitit 2021, në institucionet e arsimit parashkollor janë regjistruar 192 fëmijë të kombësisë rome dhe egjiptiane (99 djem dhe 93 vajza), dhe në shkollat fillore 1856 nxënës/e (960 djem dhe 896 vajza), ndërsa në shkollat e mesme u regjistruan gjithsej 207 nxënës/e (115 djem dhe 92 vajza).

Në vitin akademik 2021/2022, numri i studentëve/eve nga popullsia rome dhe egjiptiane ishte 12 (7 djem dhe 5 vajza).

Në vitin 2020/2021, në nivelin e arsimit parashkollor, mësimi dygjuhësh është zhvilluar në institucionet parashkollore të IPP "Kopshti" në Plavë, IPP "Gjina Vrbica" në Tuz, IPP "Vukosava Ivanoviq - Mashanoviq" në Tivar dhe IPP "Solidaritet" në Ulqin, gjithsej 372 fëmijë (197 djem dhe 175 vajza).

Në nivelin e arsimit fillor, arsimi dygjuhësh është zbatuar në Ulqin - Shkolla Fillore "Marshal Tito", Shkolla Fillore "Marko Nukuloviq" dhe Shkolla Fillore "Boshko Strugar"; në Tuz - Shkolla Fillore "Mahmut Lekiq"; në Plavë - Shkolla Fillore "Hajro Shahmanoviq", dhe në Guci

- Shkolla Fillore "Xhafer Nikoçeviq". Arsimin fillor në gjuhën shqipe e kanë ndjekur 2564 nxënës/e, nga të cilët 1295 djem dhe 1269 vajza.

Në nivelin e arsimit të mesëm, gjithsej 968 nxënës/e (519 djem dhe 449 gra) kanë ndjekur mësimet dygjuhëshe në Tuz – Shkolla e Mesme e Përzier "25 Maj"; në Ulqin - Shkolla e Mesme e Përzier "Vëllazërimi - Bashkim" dhe Plavë - Shkolla e Mesme e Përzier "Beqo Bashiq".

198 nxënës/e (124 vajza dhe 74 djem) kanë ndjekur shkollat e muzikës me mësim në gjuhën shqipe. Bëhet fjalë për Shkollën Fillore të Muzikës në Ulqin dhe Institucionin Rajonal të Shkollës Fillore të Muzikës "Vasa Paviq" në Tuz.

Mësimi në gjuhën shqipe u zhvillua edhe në gjashtë shkolla fillore: Shkolla Fillore "Gjergj Kastrioti Skenderbeu" në Tivar; Shkolla Fillore "29 Nëntori", Shkolla Fillore "Bashkimi" dhe shkolla fillore "Gjergj Kastrioti Skënderbeu" në Tuz; Shkolla Fillore "Bedri Elezaga" në Ulqin, dhe Shkolla Fillore "Dacaj" në Rozhajë, me gjithsej 2.564 nxënës/e (1.295 djem dhe 1.269 vajza). Në Gjimnazin Privat "Drita" në Ulqin, mësimi zhvillohet edhe në gjuhën shqipe.

Në vitin akademik 2020/2021 në programin e studimit për mësues/e në gjuhën shqipe janë regjistruar 15 studentë/e.

Në shtator të vitit 2020, në arsimin parashkollor u regjistruan 224 fëmijë të kombësisë rome dhe egjiptiane (118 vajza dhe 106 djem). Në shkollat fillore janë regjistruar 1793 nxënës/e të shkollave fillore (929 djem dhe 864 vajza) nga klasa e I deri në IX. Në të njëjtën kohë, në shkollat e mesme janë regjistruar gjithsej 174 nxënës/e të shkollave të mesme (101 djem dhe 73 vajza).

Numri i studentëve/eve nga popullsia rome dhe egjiptiane në vitin akademik 2020/2021 ishte 17 (9 femra dhe 8 mashkuj).

# Multikulturalizmi dhe ndërkulturaliteti - parakushtet për bashkëjetesë të qëndrueshme në mes kulturave të ndryshme

Multikulturalizmi i referohet ekzistencës së kulturave të ndryshme brenda një shoqërie ose komuniteti, të cilat janë të përfaqësuara dhe të njohura, dhe me dallimet e të cilave njerëzit jetojnë së bashku. Shoqëria multikulturore njeh dhe vlerëson diversitetin e kulturave, gjuhëve, zakoneve dhe vlerave. Në mjedisin multikulturor, individët kanë të drejtë të ruajnë dhe shprehin kulturën e tyre, dhe në shoqëri kjo respektohet dhe ata kanë mundësi të barabarta.

Ndërkulturaliteti i referohet mirëkuptimit, ndërveprimit dhe dialogut të ndërsjellë ndërmjet kulturave të ndryshme. Interkulturalizmi synon të tejkalojë paragjykimet, stereotipet dhe konfliktet ndërmjet kulturave të ndryshme përmes mësimin, respektit dhe pranimit të ndërsjellë. Qëllimi kryesor është zhvillimi i kompetencës ndërkulturore, e cila përfshin mirëkuptimin, ndjeshmërinë dhe aftësinë për të komunikuar me njerëz nga kulturat e tjera. Ndërkulturalizmi promovon hapjen, tolerancën, vlerësimin dhe bashkëpunimin midis njerëzve me prejardhje të ndryshme kulturore.

Pra, derisa multikulturalizmi i referohet diversitetit të kulturave në shoqëri, ndërkultura fokusohet në mirëkuptimin reciprok, respektin dhe ndërveprimin midis këtyre kulturave të ndryshme. Të dy konceptet janë të rëndësishme në ndërtimin e shoqërive gjithëpërfshirëse dhe harmonike ku diversiteti pranohet, respektohet dhe jetohe.

# Ndërkultura në procesin arsimor dhe edukativ

Detyra themelore e shkollës, por edhe e shoqërisë, është të përgatisë popullatën më të re për jetën në një shoqëri të diversitetit. Në mënyrë që shoqëritë, por edhe vetë shkolla, të përmbushin detyrën, të kontribuojnë në mënyrë aktive në ndërtimin e sërë kompetencash të nevojshme për jetën në shoqëri multikulturore, është e nevojshme të trajtohen të rinjtë për të tejkaluar konfliktet, për të zhvilluar tolerancën, të pranojnë të tjerët dhe dallimet, por edhe për të treguar gatishmëri për të vënë në dyshim qëndrimet e veta.

Arsimi dhe edukimi ndërkulturore është faktor i rëndësishëm i bashkëjetesës në shoqëri multikulturore dhe nis nga realiteti ku institucionet arsimore janë vend i kulturave, gjuhëve dhe feve të ndryshme. Këto dallime shpesh paraqesin sfida për individin dhe shoqërinë, dhe për t'i adresuar ato në mënyrë adekuate, është e nevojshme që sistemi arsimor të jetë i cilësisë së lartë. Kjo është arsyeja pse ka nevojë për përshtatje të vazhdueshme të arsimit me standardet demokratike të shoqërisë kulturore-plurale evropiane dhe ideja e ndërkulturalizmit në sistemin arsimor shihet nga shumë njerëz si mënyrë e mundshme për bashkëjetesë cilësore në shoqëri multikulturore.

Në programet e mësimdhënies që integrojnë ndërkulturën, kulturën, feja dhe përkatësinë etnike nuk shikohen vetëm si një koleksion informacioni për t'u përcjellë nxënësve/eve, por promovojnë në mënyrë aktive ndërveprimin dhe dialogun ndërmjet nxënësve/eve të kombësive, feve dhe kulturave të ndryshme. Kjo qasje i inkurajon nxënësit/et të mendojnë në mënyrë kritike për supozimet, stereotipet dhe paragjykimet e tyre, si dhe të zhvillojnë aftësinë për të empatizuar dhe kuptuar.

Ndërkulturaliteti në sistemin arsimor dhe edukativ nuk lidhet vetëm me një lëndë apo grup lëndësh - ai është parimi i punës mbi të

cilin mbështetet i gjithë mësimi në shkollat fillore dhe të mesme. Një nga katër shtyllat e edukimit është *"të mësuarit për të jetuar së bashku"*, e cila arrihet më së miri përmes idesë së ndërkulturalizmit në mësimdhënie.

Interkulturalizmi në mësimdhënie synon rezultatet: përgatitjen e nxënësve/eve për të përballuar dallimet; përgatitjen e nxënësve/eve për reagime pozitive dhe kuptimin e diversitetit si mundësi për të fituar përvoja të reja; shqyrtimi i problemeve sociale dhe arsimore që lidhen me dallimet kulturore; përvetësimi i njohurive dhe aftësia për të zbatuar njohuritë për të tjerët dhe tjetërsinë; zhvillimi i aftësisë së të menduarit kritik; duke njohur të drejtën e të tjerëve për të zotëruar një identitet kulturor; zhvillimi i ndjeshmërisë sociale dhe ndjenjës për zgjidhjen e problemeve sociale; zhvillimi i aftësisë për të bashkëpunuar në mjedis multikulturor.<sup>7</sup>

Roli i shkollës është veçanërisht i rëndësishëm në përvetësimin e kompetencave ndërkulturore, pranimin dhe vlerësimin e diversitetit, veçanërisht në mënyrë që fëmijët në komunikim të drejtpërdrejtë, shoqërim dhe mësim me pjesëtarët e pakicave të tjera kombëtare të mund të ndërtojnë qëndrimet e tyre dhe të thyejnë paragjykimet që u paraqiten çdo ditë nëpërmjet mjeteve të ndryshme informative. Në këtë kontekst, mediat janë gjithashtu shumë të rëndësishme. Hulumtimi i Qendrës për Arsimim Qytetar (QAQ) mbi qëndrimet e qytetarëve për çështjet e multikulturalizmit në Mal të Zi tregon se rreth dy të tretat e të anketuarve besojnë se mediat ndikojnë në formimin e qëndrimeve ndaj pakicave kombëtare, ndërsa një e treta e të anketuarve nuk kanë atë mendim. Gjithashtu, nga ata që besojnë se media ndikon në formimin e qëndrimeve ndaj pakicave kombëtare, pjesa më e madhe besojnë se ky ndikim është negativ (44.7%), ndërsa përqindja e përafërt e atyre që besojnë se ky ndikim është neutral ose pozitiv.<sup>8</sup>

---

**7** Interkulturalizmi në mësimdhënie, Marija Sabliq, 2014, fq 159

**8** Hulumtim mbi qëndrimet e qytetarëve për çështjet e multikulturalizmit në Mal të Zi, Qendra për Arsimim Qytetar (QAQ), Prill 2023, <https://media.cgocce.org/2023/04/CGO-istrazivanje-multikulturalnost-finalno-sajt.pdf>



Sipas Raportit Vjetor për Cilësinë e Punës së Institucioneve Arsimore dhe Edukative për vitin 2022<sup>9</sup>, në fushën e *mbështetjes së nxënësve*, rezultati i përgjithshëm, në shkallën nga X në Y, ishte 6.36 për shkollat fillore, dhe ky është rezultati më i keq i të gjithë parametrave të vlerësuara. Për shkollat e mesme ai vlerësim është edhe më i keq - 5.93, që me parametrin e *menaxhimit dhe udhëheqjes së institucionit* me vlerësim 5.41 e bën atë më të ulët. Për më tepër, në raport thuhet se "në një shkollë mund të vërehet angazhim i pamjaftueshëm ndaj nxënësve RAE". Gjithashtu, theksohet se gjatë përpunimit të nëntë shkollave të mesme, "rezultatet e anketave tregojnë se marrëdhëniet ndërpersonale mes nxënësve dhe nxënësve dhe mësuesve nuk janë gjithmonë në nivel të lartë". Vihet re se një nga mangësitë është realizimi i rrallë i aktiviteteve jashtëshkollore në përputhje me nevojat dhe interesat e nxënësve/eve. Pikërisht aktivitetet jashtëshkollore mund të jenë një mjet efektiv për përmirësimin e ndërgjegjësimit për ndërkulturalizmin, bashkëjetesën, pranimin e diversitetit dhe njohjen e kulturave të reja. Konkretisht mund t'i referohet organizimit të vizitave në monumente, mësimeve për zakonet dhe kulturat e pakicave kombëtare etj.

Të gjitha institucionet arsimore duhet të ndërtojnë një mjedis shkollor fuqizues që mundëson dhe inkurajon zhvillimin e çdo individi, fuqizon në mënyrë të barabartë anëtarët/et e grupeve dhe kulturave të ndryshme etnike, redukton paragjykimet dhe ndryshon qëndrimet negative të nxënësve/eve ndaj diversitetit.

Arsimi ndërkulturor në sistemin arsimor-edukativ të Malit të Zi ka rrugën e vet të zhvillimit. Gjegjësisht, sistemi arsimor i Malit të Zi, pas Luftës së Dytë Botërore, bazohej kryesisht në pedagogjinë socialiste, e cila ishte më shumë e orientuar drejt nevojave kolektive sesa ndaj individit dhe nevojave të secilit individ. Kjo qasje ndaj arsimit vazhdon të luajë një rol të rëndësishëm në sistemin arsimor malazez, veçanërisht në mesin e stafit mësimdhënës të brezit të vjetër.

---

<sup>9</sup> Raport vjetor për cilësinë e Bordit të Arsimit për vitin 2022, Instituti për Arsim i Centar për formim profesional, Podgoricë, 2023.

Në punimin kërkimor shkencor *“Treguesit e zhvillimit të multikulturalizmit dhe vetëdijes qytetare në fëmijërinë e hershme (parashkollor dhe cikli i parë i shkollës fillore) në sistemin arsimor të Malit të Zi”*<sup>10</sup> të, Dr. Sasha Miliq, përmes analizës së ndërkulturalitetit dhe ndërgjegjësimit qytetar në sistemin arsimor, shtron pyetjen nëse sistemi arsimor është mjaft efektiv dhe nëse është në përputhje me nevojat e fëmijës dhe shoqërisë.

Rezultatet e hulumtimit për përfaqësimin e qasjes individuale në procesin arsimor-edukativ tregojnë se ende ekziston një imazh tradicional i nxënësit/es mesatar, i cili indukon neglizhimin e aftësive individuale të nxënësit/es në procesin e edukimit. Edhe pse janë vërejtur disa përparime, më shumë se 60% e mësuesve/eve ende nuk e zbatojnë mjaftueshëm qasjen e individualizuar. Prandaj, ekziston nevoja e dukshme për trajnime shtesë të stafit mësimdhënës në këtë fushë.

Është gjithashtu shqetësues fakti se në kuadër të treguesit të *krijimit të procesit mësimor që mbështet zhvillimin e ndërkulturës dhe ndërgjegjësimit qytetar*, rezultatet më të këqija kanë mësuesit/et nga rajoni verior, duke pasur parasysh se qytetet në veri të Malit të Zi janë kryesisht multietnike, gjë që i jep kësaj një peshë të veçantë. Është personeli mësimdhënës në mjediset multietnike ai që duhet të kujdeset prerazi për zhvillimin e ndërkulturës në procesin arsimor dhe edukativ.

Mësuesit/et me arsim të lartë profesional tregojnë shumë më tepër vëmendje ndaj qasjes së individualizuar në procesin arsimor krahasuar me kolegët/et e tyre me arsim më të ulët profesional. Kjo tregon se nëpërmjet edukimit më të madh, tek mësuesit/et zhvillohen edhe kompetencat e nevojshme për një qasje të individualizuar në punën pedagogjike.

---

**10** Treguesit e zhvillimit të multikulturalizmit dhe ndërgjegjësimit qytetar në fëmijërinë e hershme (parashkollor dhe cikli i parë i shkollës fillore) në sistemin arsimor të Malit të Zi, Dr Sasha Miliq, 2011.

Fatkeqësisht, vëmendja e pamjaftueshme që i është kushtuar çështjes së komunikimit pedagogjik në edukimin e mësuesve/eve gjeti shprehjen e saj në rezultatet e hulumtimit. Krahasuar me treguesin e qasjes së individualizuar, mësuesit/et arritën rezultate më të ulëta në treguesin që lidhet me aspektet e komunikimit të zhvillimit të ndërgjegjësimit ndërkulturor dhe qytetar. Komunikimi i tyre ndaj nxënësve/eve ende karakterizohet nga qëndrime autoritare dhe pritshmëri që mësuesi/ja të jetë elementi kyç në procesin arsimor-edukativ. Ndryshe nga qasja e dëshirueshme që ka në qendër fëmijën, e cila pranohet gjerësisht në sistemet arsimore moderne (*child-centered approach*), në sistemin arsimor malazez, qasja që fokusohet te mësuesi (*teacher-centered approach*) ende mbizotëron.

Kjo përkujton, ndër të tjera, nevojën për përmirësimin e vazhdueshëm të kuadrit mësikor, veçanërisht në mjediset multi-etnike. Në Katalogun e zhvillimit profesional të mësimeve në periudhën 2022-2024<sup>11</sup> janë gjithsej 279 programe, por numri i programeve që drejtpërdrejt ose tërthorazi kanë të bëjnë me temat e pakicave, bashkëjetesës, multikulturalizmit dhe ndërkulturës është vetëm 11 ose 3.94% nga të gjitha programet. Bëhet fjalë për programet e mëposhtme: "*Edukimi për të drejtat e njeriut si temë ndërkurrikulare*"; "*Nacionalizmi si arsye për konfliktin e bashkëmoshatarëve – sfida e mësuesit*"; "*Shtypja e gjuhës së urrejtjes në internet*"; "*Punë edukative me fëmijët dhe të rinjtë e popullsisë emigrante*"; "*Punë edukative me fëmijët dhe të rinjtë e popullatës RE – niveli bazë*"; "*Punë edukative me fëmijët dhe të rinjtë e popullatës së RE - niveli i avancuar*"; "*Parandalimi i braktisjes së shkollës*"; "*Edukimi ndërkulturor*"; "*Inkurajimi i kulturës demokratike në shkollë*"; "*Zhvillimi i kompetencave ndërkulturore të mësuesve*"; "*Përdorimi i mediave për pjesëmarrje në shoqëri demokratike*".

---

<sup>11</sup> Katalogu i programeve të formimit profesional të mësuesve për periudhën 2022-2024, <https://cg.e-seminari.net/wp-content/uploads/2022/12/KATALOG-PROGRAMA-STRUCNOG-USAVRSAVANJA-NASTAVNIKA-2022-2024..pdf>

Duke qenë se kjo është një fushë mjaft e gjerë dhe komplekse, veçanërisht nga aspekti i kushteve sociale në Mal të Zi, numri i programeve në lidhje me këto tema duhet të jetë më i madh. Për më tepër, ky detyrim buron nga një nga qëllimet e Strategjisë për Edukimin e Mësimdhënësve në Mal të Zi 2017-2024<sup>12</sup> - *“puna në shoqëri dhe me shoqërinë - mësuesit janë profesionistë të përgjegjshëm që bashkëpunojnë me aktorë të ndryshëm dhe mjedisin e tyre dhe promovojnë zhvillimin e nxënësve si qytetarë të përgjegjshëm globalë, duke inkurajuar pikëpamjet e tyre për bashkëpunimin dhe lëvizshmërinë, dialogun ndërkulturor, tolerancën dhe respektin për tjetrin dhe tjetërsinë.”*

Kompetencat e mësuesit/es për arsimin ndërkulturor përfshijnë disa aspekte të ndryshme në kontekstin e teorisë multikulturore dhe ndërkulturore, siç përcaktohet nga Xhejms A. Banks, shkencëtar i njohur amerikan dhe pionier në fushën e arsimit ndërkulturor.

Sipas Banks<sup>13</sup> kompetencat kryesore të mësuesve përfshijnë:

1. njohja e karakteristikave të nxënësve/eve – mësuesit/et duhet të jenë të njohur me karakteristikat e ndryshme të nxënësve/eve, duke përfshirë prejardhjen e tyre kulturore, gjuhën, zakonet, vlerat dhe përvojat. Kuptimi i këtyre karakteristikave i ndihmon ata të përshtatin qasjen e tyre dhe të krijojnë një mjedis gjithëpërfshirës dhe mbështetës për të gjithë nxënësit/et;
2. përshtatja e stileve të mësimdhënies me stilet e të mësuarit – mësuesit/et duhet të jenë në gjendje të njohin stilet e ndryshme të të mësuarit të nxënësve/eve të tyre dhe të përshtatin metodat e tyre të mësimdhënies për të përmbushur nevojat e tyre individuale;

---

**12** Strategjia e edukimit të mësuesve në Mal të Zi 2017-2024. me plan veprimi, <https://www.gov.me/dokumenta/6d7f693f-fd43-4869-80a5-09cba4f2e87a>

**13** Race, Culture, and Education: The Selected Works of James A. Banks, 2006.

3. njohuri të detajuara dhe të kuptuarit fleksibël të përmbajtjes së lëndës – mësuesit/et duhet të njohin mirë përmbajtjen e lëndës që ligjërojnë, por në të njëjtën kohë të kenë fleksibilitet në qasjen e tyre për të mundësuar mënyra të ndryshme të lidhjes me përvojën e nxënësit/es. Kjo do të thotë se ata duhet të jenë në gjendje të lidhin hendekun midis njohurive të shkollës dhe përvojës së nxënësve/eve;
4. aftësitë e menaxhimit të klasës – mësuesit/et duhet të kenë aftësinë për të menaxhuar në mënyrë efektive klasën, e cila përfshin krijimin e energjisë pozitive, inkurajimin e bashkëpunimit ndërmjet nxënësve/eve dhe promovimin e sjelljes së përgjegjshme;
5. menaxhimi i modeleve të sjelljes në grup nxënësish – mësuesit/et duhet të kenë aftësinë për të menaxhuar modele të ndryshme të sjelljes në grup nxënësish, duke përfshirë kuptimin dhe trajtimin e konflikteve, promovimin e përfshirjes dhe të kuptuarit e këndvështrimeve të ndryshme.

Në qasjen ndërkulturore ndaj arsimit dhe edukimit, zgjedhja e metodave të mësimdhënies dhe formave të punës në mësimdhënie varet nga faktorë të ndryshëm, si qëllimet e procesit mësimor, përmbajtja mësimore, moshja dhe përvoja e nxënësit, kualifikimet e mësuesve/eve dhe mjedisit social.

Qëllimi kryesor i edukimit ndërkulturore është ndryshimi i sjelljes, i cili mund të arrihet vetëm nëse përvetësimi i njohurive çon në ndërtimin e një sistemi vlerash. Pikërisht për këtë është e rëndësishme të mësoh në/për mjedisin ku të drejtat dhe liritë e individit/es vlerësohen, respektohen dallimet dhe ushqejnë kulturën e dialogut.

Gjithashtu, është e nevojshme të krijohet atmosfera shkollore në të cilën të drejtat e njeriut janë pjesë qendrore e të mësuarit, vlera që aspirohen dhe që promovohen dhe mbrohen. Është e rëndësishme të sigurohet që çdo nxënës/e të kuptojë konceptet kryesore të ndërkulturalizmit dhe t'i pranojë ato si vlera mbi të cilat bazohet sjellja

dhe të respektojë dallimet e secilit person, të gjitha me qëllim që të zhvillohet mirëkuptimi dhe respekti për dallimet. Kjo kërkon aplikimin e metodave mësimore dhe formave të punës që nxisin bashkëpunimin dhe komunikimin në grupe heterogjene dhe afirmojnë barazinë e të gjithë nxënësve/eve për pjesëmarrjen në procesin mësimor. Disa nga metodat e rekomanduara të mësimdhënies dhe format e punës në edukimin ndërkulturor përfshijnë mësimdhënien kërkimore, mësimdhënien në terren, studimet e rasteve, punën duke përdorur tekste gazetash, lajttjen e roleve, shkrimin e (auto)biografisë, simulimet, mësimin ndërveprues, ndërmjetësimin, etj.

Me zhvillimin e kompetencave ndërkulturore, nxënësit/et bëhen më të përgatitur për t'u përballur me sfidat e shoqërisë moderne. Së fundi, kjo është mënyra se si ata zhvillojnë inteligjencën kulturore që u mundëson atyre të marrin pjesë si qytetarë dhe qytetare me potencialin e tyre të plotë në shoqëri multikulturore.

# Përfundime dhe rekomandime

Në nivelin e përgjithshëm, mbizotëron perceptimi i qytetarëve dhe qytetareve se shoqëria malazeze është multikulturore, të cilën e theksojnë pak më shumë se 80% e të anketuarve/ave, dhe pak më pak se një e pesta kanë mendim të kundërt. Megjithatë, kur shqyrtohet thellësisht edhe kur disa çështje reflektohen në nivel personal, vihet re një situatë krejtësisht e ndryshme e ngarkuar me distanca dhe paragjykime serioze, sipas rezultateve të sondazhit të opinionit publik mbi multikulturalizmin në Mal të Zi<sup>14</sup>, kryer nga QAA si pjesë e projektit *"Multikulturalizmi, popujt pakicë dhe komunitetet e tjera kombëtare pakicë në sistemin arsimor malazez"*, me mbështetjen financiare të Fondit për Mbrojtjen dhe Realizimin e të Drejtave të Pakicave.

Hulumtimi vë në dukje edhe shkallën shqetësuese të distancës fetare dhe etnike, e cila është më e theksuar në raport me pjesëtarin/en e familjes ose me anëtarin/en e familjes së partnerit/es. Në mjedisin e punës dhe atë të përgjithshëm, shënohet një frekuencë pak më e ulët, por ende ekziston. Ekziston qëndrim i polarizuar kur bëhet fjalë për martesën me partner/e të një grupi tjetër etnik - 50.4% e të anketuarve/ave nuk do të martoheshin me partner/e të një grupi tjetër etnik, dhe gati tre të pestat (58%) e të anketuarve/ave deklaruan se nuk do të lidhnin martesë me partner/e të një feje tjetër. Për më tepër, rezërvim ndaj anëtarëve/eve të një grupi tjetër etnik ose feje shprehet nga pothuajse 30% e të anketuarve/ve, dhe rreth 60% besojnë se shumica e incidenteve që kemi parë publikisht në shoqëri në dy vitet

---

**14** Hulumtim mbi qëndrimet e qytetarëve për çështjet e multikulturalizmit në Mal të Zi. Qendra për Arsimitim Qytetar (QAA), Prill 2023, <https://media.cgo-ccc.org/2023/04/CGO-istravanje-multikulturalnost-finalno-sajt.pdf>

e fundit janë kryesisht të motivuara nga intoleranca fetare dhe etnike, ndërsa pak më pak 40% nuk kanë mendim të kundërt. Pothuajse 60% e të anketuarve/ave besojnë se temat që kanë të bëjnë me kulturën e popujve pakicë janë të përfaqësuar pjesërisht dhe në mënyrë adekuate në tekstet shkollore, ndërsa një e treta (33.7%) deklarojnë se janë të përfaqësuar në mënyrë të pamjaftueshme.

Në drejtim të përmirësimit të sistemit arsimor në pjesen e zhvillimit të multikulturalizmit dhe ndër-kulturalizmit, ndër të tjera rekomandohet që:

- gjatë vlerësimeve eksterne në shkolla, të vlerësohet zhvillimi i "kompetencave qytetare për kulturën demokratike"<sup>15</sup>;
- të zhvillojë trajnime të rregullta për zhvillimin e kompetencave intelektuale të kuadrit mësimor, veçanërisht të atyre mësimdhënësve/eve që punojnë në mjedise multietnike;
- në programet për lëndën e *Historisë*, rezultatet arsimore janë formuluar në atë mënyrë që mësimi të përfshijë si situatat konflikti nga e kaluara e afërt, ashtu edhe trashëgiminë e përbashkët dhe specifike historike dhe kulturore, periudhen e bashkëjetesës së popujve/bashkësive etnike të ndryshme në kornizat rajonale dhe evropiane;
- të organizohen më shumë aktiviteve në shkolla, veçanërisht në rajonin verior të Malit të Zi, në mënyrë që nxënësit/et të mësojnë drejtpërdrejt për kulturën e pakicave dhe bashkëjetesën në bashkësitë multietnike;
- të zhvillohen mekanizma mbështetës për nxënësit/et e RE në përvetësimin e materialit mësimor, si dhe sigurimin e teksteve shkollore dhe burimeve të nevojshme, të cilat do të ndikojnë në integrimin më të mirë të tyre;

---

**15** Kompetenca për kulturën demokratike - për të jetuar së bashku si shoqëri demokratike të diversitetit kulturor, Këshilli i Evropës, <https://rm.coe.int/competences-for-democratic-culture-srp/1680782138>



- të organizohen aktivitete jashtëshkollore që do të kontribuojnë në kuptimin më të mirë të kulturës dhe zakoneve të pakicave kombëtare;
- në kuadër të shoqatave të mësuesve të zbatohen programe shkëmbimi të profesorëve/eshave dhe nxënësve/eve nga rajone të ndryshme (pjesëtarët e bashkësive të ndryshme etnike) me qëllim të shkëmbimit të përvojave dhe zhvillimit të dialogut ndërkulturor;
- tregime për shembujt pozitivë të veprimeve të individëve, pjesëtarëve/eve të pakicave kombëtare dhe kontributit të tyre në zhvillimin e shoqërisë.



# MULTI KULTU RALI ZMI

dhe komunitetet kombëtare më  
pak të përfaqësuar në sistemin  
arsimor malazez



